

**Nijazi Basha**

**Mbi mendimin  
dhe  
diturinë**

[www.sa-kra.ch](http://www.sa-kra.ch)

[www.syri3.com](http://www.syri3.com)

**Autorizimin ekskluziv për editimin  
e këtij libri në internet, e kane  
vetëm këto faqe shqiptare:**

[www.sa-kra.ch](http://www.sa-kra.ch)

[www.syri3.com](http://www.syri3.com)

(E falënderojmë autorin për zemërsisht)

**NIJAZI BASHA**

**Mbi mendimin dhe diturinë**

Të formuluar nga vitet 1980-2000

Zürich  
Shtator 2005

**Biblioteka  
VETËDIJA JONË**

**Lektura dhe redaktimi  
Hafir Sedolli**

*Ne jetojmë në kopshtin e fshehtësive, prej  
të cilave fshehtësi varet vet jeta jonë.*

## **Ku? Çka? Si? Kur? Pse?**

### **Ku?**

Atje ku është nevoja.

### **Çka?**

Atë të tashmen dhe të arsyeshmen.

### **Si?**

Ashtu si është më qartë, më lehtë, më mirë dhe më saktë.

### **Kur?**

Në momentin e volitshëm ose sa është pa u bërë vonë.

### **Pse?**

Sepse ka nevojë jeta.

Ne mendojmë natë e ditë, në çdo kohë dhe moment atë çka dijmë ta korrigojmë dhe përmirësojmë, dita-ditës më shumë. Fjalëve të pamatura e të tepruara t'u vëmë kufi: nervozitetit, shprehive të dobëta...

Mendimi , ideja, fantazia, dyshimi, konsultimi nuk kanë kufi. Ato përbëhen prej kohës, fjalës, bisedës, nevojës, arsyes, vullnetit, dëshirës apo ndjenjave. Njeriu që flet, jep mendime, atyre mos t'u vërë kufi. Përfundimtare nuk është asnjë zgjidhje sepse fshehtësitë dhe gjërat e panjohura janë më të mëdha se ato që i dimë më së miri deri më tani.

**Ne jetojmë në kopshtin e fshehtësive,  
prej të cilave fshehtësi varet vet jeta  
jonë.**

Veprat tona që dëshirojmë t'i bëjmë tani dhe më vonë, i shprehim me dëshirë me anë të veprës, punës dhe këshillës. Por, sidoqoftë ne gjithnjë në çfardo dëshire për punë dhe këshillë nevoja e domosdoshme është të lidhemi me kohën e tashme (gjithnjë duhen përmirësime, më saktë të thuhet, imponim i një shprehie).

Disa gjëra mund të mendohen mirë dhe qartë, por vështirë është të shpjegohen. Ka edhe gjëra që shumë mirë mendohen dhe shpjegohen, por vështirë është të shkruhen. Tani ka gjëra, mirë mendohen, mirë shkruhen.

Si çdo shtëpi që varet nga kujdesi, poashtu edhe trupi i njeriut varet prej kujdesit, ku përparësi e veçantë është mirëmbajtja dhe shfrytëzimi me vend, kryesisht nën kontrollin e vetëdijës (arsyes) së plotë.

A ka mundësi të përcillen disa detaje si p.sh. ditët e javës, hëna e plotë apo e re, disponime apo hutitë personale të rrethit ku jetohet, ashtu që atmosfera e ndriçimit mes nesh në komunikim të ketë kuptim më të qartë.

Kur bisedojmë duhet të kemi kujdes më shume sesa kur lexojmë. Prandaj, ajo çka flitet, sipas mundësive, le të jetë sa më e saktë, e shkurtër dhe e qartë.

Këshillat sado shumë të jipen, nuk kanë rezultate të mjaftueshme edhe nëse është

shumë edukatë me vend. Dy këshilla që zëvendësohen me një vepër konkrete janë më të vogla se vet vepra. Kritika me vend dhe përqeshja me vend më shumë ndikojnë negativisht sesa pozitivisht. Urtia dhe matura janë këshillat më të fuqishme.

Ai që nuk di ta shfrytëzoj rastin që i është dhënë, nuk di të krijoj rast të qëllimshëm.

Ai që është i zoti ta shfrytëzoj rastin, ka aftësi edhe ta krijoj vet rastin për nevojat e tij.

Të gjitha mendimet, veprimet, planet, idetë, zhvillimet dhe çdo perspektivë e ka vlerën e vet. Duhet të mendojmë vetëm pak si t'i mbrojmë qëllimet e arritura që të mos rrezikohen nga një dredhi a ndonjë tradhti.

Puna, vullneti dhe dija me vetëdije, janë drita dhe liria e njeriut (apo popullit).

**Çdo hap që pëcillet me tingullin e vetëdijës, paraqet zgjimin dhe mirëfillin e tij.**



Sa më i afërt që të jeshë me shoqëri në aspektin bashkëpunues, aq më i pasur do të jeshë me dituri, shëndet e pasuri.

Rrugën e mirë nëse e kërkon, do ta gjesh vetëm atje ku lulëzon puna.

Studio ku shkon, çka sheh, çka dëgjon. Në çdo shoqëri të re, së pari studioi, informohu për të dhe punën e tyre. Ndërsa, kurrë mos ndërhyj i pari të tregohesh apo të lëvdohesh.

Në luftën psikike kurrë nuk bën të ndërhysh i pari. Ndërsa, në luftën fizike mund të ndërhysh nëse ka nevojë.

Në çdo veprim, çdo punë dhe çdo sukses tëndin, mos e bëj për t'u treguar se çka di apo çka mund të bësh. Nëse e bën, bëje vetëm për t'u ndihmuar tjerëve, rrethit ku jeton, popullit apo njerëzimit.

Mendjen e ke shokun më të afërt të jetës, më besniken dhe ndërkohë mund ta keshë tradhtaren më të rrezikshme të jetës tënde.

Mos iu frigo shtypjes dhe varfërisë.  
Drejtoju diturisë se ajo është kundër tyre.

Asgjë nuk është varfëria për njeriun e  
vetëdijshëm.

Më e rrezikshmja për njeriun është  
mendjemadhësia ose mosmarrëveshja e tij.

Prej shokëve më të ngushtë e ke vullnetin,  
punën dhe vetëdijën.

Ardhmëria më e pastër dhe liria e shpirtit të  
kulturës, gjuhës, shkencës apo artit arrihet  
vetëm me punën e palodhur prej njerëzve  
intelektualë.

I lum ai që ka pasuri materiale dhe dituri  
për ardhmërinë e popullit dhe vendit.

Për të pasur sukses në punën tënde, bëhu i  
afërt dhe i lidhur ngusht me shokë të  
shoqëruar, entuziast dhe intelektual.

Nëse je i pasur, ke kujdes të mos mbesh i  
varfër në aspektin njerëzor dhe kombëtar.

Ruaju mos të sëmuresh prej kapitalit vetiak sepse kjo sëmundje të le të gjymtë jo vetëm në aspektin njerëzor, por edhe në atë kombëtar.

Nëse ke kapital ose pasuri, mundohu ta shfrytëzosh jo vetëm për të grumbulluar kapital për vete. Rrite e shtoje pasurinë por sa më shumë shfrytëzoje që t'i kontribosh shoqërisë sepse në këtë mënyrë do ta ndërtosh rrugën më të mirë për vendin ku jeton.

Jeta më e bukur mund të bëhet atje ku punohet dhe këndohet. Kënga edukuese ku ka karakter e moral të pastër, ka edhe ide të përbashkëta e përparimtare.

Nëse punon me dashuri për vete për popullin tënd dhe njerëzimin do të keshë pasuri të pashtershme, e nëse punon vetëm për vete, ajo pasuri ta humb karakterin njerëzor.

Ai njeri që ka harmoni me shokë dhe hap biseda të ardhmërisë së vendit, për rrethin krijon e ndriçon.

Kapitalin vetjak e quaj pasurinë e personave që kanë dëshirë vetëm ata ta kenë këtë kapital e të tjerët jo. Tek këta mbretëron një xhelozë primitive, ku këta nuk është mirë të dominojnë në shtet ose në një popull.

Nëse je një njeri vetjak dhe nuk të intereson asgjë për shoqërinë dhe as për vendin, dije se je i sëmurë prej interesit vetjak.

Sëmurja për interesi dhe kapital vetjak janë motër e vëlla dhe nëna e poshtërsisë.

Prej mendjemadhësisë lind interesi vetjak, prej interesit vetjak lind poshtërsia.

Që njeriut të mos ia merrni vetëm anët e këqija, duhet së pari t'ia kujtoni edhe anët e mira.

Mendimet apo ëndërrat që të kënaqin, shumë të mashtrojnë.

Çdo gjë që punohet, lexohet me logjikë dhe interesim, e ka kuptimin e vet të qartë dhe të kënaqshëm.

Çdo gjë që e punon me interesim dhe vullnet, nuk ndien lodhje, e ato punë kryhen shumë më me sukses.

Nëse e sheh njeriun që s'ka aq aftësi dhe dituri të pastër, është mendjemadh, mos u thello me të në biseda të ardhmërisë, sepse nga ai person do të nënçmohesh. Biseda të pastërta, të mirëseardhura mund të bëhen me njerëzit e zellshëm e të interesuar.

Çdo gjë që punohet, lexohet me logjikë dhe interesim, e ka kuptimin e vet të qartë.

Një gjë që e punon me interesim nuk ndien lodhje, dhe ato punë i kryen më mirë.

Suksesi i madh në një drejtim mund të arrihet vetëm nëse i rrekesh seriozisht dhe koncentrimin mbi të duhet ta keshë në çdo hap dhe në çdo kohë të vetëdijësuar.

Mendimet (ëndërrimet) e kota janë të pasuksesshme dhe as që mund të realizohen. Nëse planifikohet dhe fillohet një punë, ajo do të kryhet. Nëse nuk fillohet, kurrë nuk kryhet, sepse puna rri në vend e koha shkon.

Në një punë që tregon sukses, do të jeshë mjaft i lumtur. Nëse nuk tregon sukses, do të jeshë i mërzhitur. Pra, lumturojeni veten!

Natyrën studioje nga jeta jote praktike, por studioje edhe nga ata të cilët e kanë studiuar praktikën e jetës së tyre.

Sado që njeriu të mësoj me interesim, nëse është i sëmurë prej ëndërrimeve e mendimeve, e largojnë nga vetëdija. Nëse largohesh nga kjo vetëdije, ke probleme e brenga, je i ndarë prej shoqërisë dhe nuk je i disponuar. Në jetë dhe shoqëri ai njeri ka për të pasur probleme dhe koncentrim të dobët në aftësinë e të mbajturit mend dhe në zhvillimin e sistemit trunor. Këto pra, e varfërojnë njeriun për dituri e vetëdije.

Njeriu kur të bisedoj, nuk don të thotë se ai menjëherë mund ta lidh në kohë tërë qëllimin e vet që e ka në bisedë. Qëllimi i të shoqëruarve duhet të jetë në çdo mënyrë t'ia ofrojmë mundësinë njëri-tjetrit kuptimin e plotë të çdo bisede. Në asnje bisedë njëri apo tjetri nuk është mirë me këmbëngulje ta paraqes mendimin e vet se

ashtu është apo nuk bën ndryshe etj. Pra, çdo bisedë duhet të korrigjohet me vëmendje, me qetësi dhe të jetë kuptimplote.

Çdo gjë që trillohet bëhet prej ndonjë interesimi.

Nëse njeriu bën gabim, në këtë rast mund të bëjmë përpjekje për përmirësim, ku paraqitet nervoza atëherë nga e cila lind përvoja dhe në këtë mënyrë bëhet një lidhje e diturisë.

Nëse njeriu jeton në mes të një kopshti me plot lule të bukura, të stolisura dhe aromatike, e në mesin e e atyre luleve ka aso lule të bukura, ku në të shikuar janë të ngjajshme dhe kanë bukuri tërheqëse por me aromë helmuese. Nëse njeriu është kokfortë jo i gjykuar nga vetëdija, ai është i pakontrolluar, mendjemadh apo i ndikuar nga ideologjitë. Ky njeri nuk do të arrij në atë rast ta shijoj dhe ta njeh shijen e aromës së këndshme të lules johelmuese. Nëse njeriu i pastër me vetëdije, kur është i pasur me ide të shëndosha, me karakter njerëzor e

që ka lidhje të ngushtë me moralin e bindjes, e ndjen dhe mund ta shpjegoj shijen dhe bukurinë e lules së këndshme.

Simptomat e prapambetorisë dhe primitivizmit janë: mosdurimi, mosmarrëveshja dhe zemërimi për gjëra qoftë të thjeshta apo të përbëra.

Mendja diturinë e kërkon e dituria mendjen e shoqëron.

Çdo punë që bëni, ndieni kënaqësi në të. Vullnetin dhe interesimin shtojeni më tepër. Në këtë rast do të keni më shumë sukses dhe shëndet më të mirë.

Kultura dhe zhvillimi ekonomik i një populli varet drejtpërdrejt nga aspektet edukative.

Aty ku s'ka moral edukativ, nuk ka as respekt, aty ku s'ka respekt, nuk ka as kulturë.

Baza dhe themeli i kulturës së një populli nisët prej edukimit e moralit të shëndoshë.



Zhvillimi i një populli shihet nëse ka bujqësi të përparuar.

Natyra e kësaj bote i ka tri robëri:

- E para është robëria shtazarake.
- E dyta, robëria shtazarake njerëzore
- E treta, robëria njerëzore

Duke u modernizuar, robëria shtazarake njerëzore viteve të fundit ka ardhur deri te koha e robërisë njerëzore. Ky është pra, zhvillimi më i lartë i kohës së fundit, dhe pikërisht në këto kohëra të fundit është paraqitur vetëdija fillestare.

Pikërisht nga këto robëri përqindja më e madhe e njerëzve nuk janë në gjendje të veprojnë në jetën e përditshme në baza të vetëdijës, por veprojnë në bazë të lakmisë, dëshirave të pakontrolluara dhe ëndërrimeve të tepruara.

### **Fundërrina e të këqijave është e mira.**

Të këqijat reshin në njeriun si shiu. Që të mos ndotet nga ato të këqija, me kohë duhet ndërtuar strehën.

Ai që me kohë e ka ndërtuar strehën, çfardo furtune apo të reshurash, edhe në befasi nuk do t'i ndodh asgjë.

**I pastër të jeshë, don të thotë ta kuptosh të keqen dhe të mos mirresh me të.**

**E keqe nuk i thuhet asaj që të vie prej momentit, por e keqe i thuhet asaj të cilës ia ndihmon rastin.**

Nëndija është toka e mirë , e plleshme, ndërsa vetëdija është bimësia frytëdhënëse e njeriut.

**Nëndija, telepatia, parapsikologjia dhe të ashtuquajturat fenomene natyrore, thjesht i shpjegojmë, vështirë i kuptojmë.**

Nëse të vie turp ta bësh një gjë prej dikujt tjetër, atëherë mos e bëj edhe prej vetes tënde.

Nëse i mësojmë gjërat e panjohura, mund të na duken fenomenale apo fantastike. Nuk duhet të ngutemi që t'i zmadhojmë ato, sepse duhet t'i kuptojmë si normale.

Gjërat e panjohura shpeshherë mund të na duken të pavlefshme ose mund t'i keqpërdorim ato.

Fëmijëve gjatë zhvillimit, mendoj se nuk mjafton vetëm t'ua imponojmë diturinë, por duhet gjetur forma si t'i nxisim për një intersim të vetëdijës së tyre. Në këtë mënyrë ata mësohen t'i kërkojnë vet ato.

Kur bëhet fjalë për gjërat e mëdha, (çështja kombëtare, historike, shkencore etj) duhet të flasim me argumente sa më të forta në lidhje me njohurinë e gjërë. Ndërsa nëse bëhet fjalë për gjëra të imëta e të parëndësishme, thash e më tha, në këtë rast argumentet e forta nuk janë aq të rëndësishme.

Qëllimkeqi dhe mendjelehti mund ta bëjnë të njejtin gabim.

Nëse kemi pasur besim tek një njeri dhe si për të zotin, vjen një ditë ku me atë person të njihemi shumë për së afërmi. Në këtë rast raporti ynë me atë person mund të ndryshoj sepse tani mund t'ia njohim edhe

dobësitë këtij personi. Më së miri është matura dhe gjindshmëria jonë të na mësoj gjëra interesante jo vetëm nga të mirat e këtij personi, por edhe nga dobësitë e tij.

Njeriu që mirret me studime dhe me aktivitete edukative në rrethin e tij, mëson si nga gjërat e këqija, poashtu edhe nga gjërat e mira.

Disa njerëz nuk dijnë të sillen mirë me aftësitë që kanë. Shkaqet janë të shumta: Një i tillë mund të jetë i varfër, jo aq i mësuar, jo i bukur, jo i shëndoshë, nuk ka fjalor të pasur, me një fjalë nuk është me gjithë të mirat. Ndoshta flet dhe mendon shkel e shko, diku është faji. Si pasojë e të gjitha këtyre gabimeve, aftësitë e këtij personi mbeten të pazbuluara. Këtij personi vetëm një ndihmë e vogël do t'i ndihmonte që aftësinë dhe talentin e tij ta shpreh plotësisht.

Fëmijës, është më mirë t'ia japim një urdhër apo një mendim të mirë? Ta pyes diçka që të më pyet ai mua; t'i lutem për diçka që të më lutet ai mua; ta urdhëroj që të më urdhëron; ta fyej që të më fyen, apo

më së miri është *ta përqafoj që të më përqafoj.*

Fëmijën nuk bën ta urdhërojmë, por më së miri është ta lusim.

Shembull: ma sjell një fletore!-ky është urdhër.

A bën të ma sjellësh atë fletore?- kjo është lutje.

Fëmiu imiton çdo gjë sepse i kupton gjërat drejtpërdrejt.

Mendimi im ka qenë dhe është, e besoj se duhet të jetë ashtu: *për të kaluarën mjafton të flasim dhe të mendojmë vetëm 5 përqind.*

Për të tashmen duhet të flasim dhe mendojmë afro 80 përqind. Mirë është të flasim e bisedojmë, ta korigjojmë atë çka e bëjmë, të bisedohet dhe mendohet për gjëra të reja p.sh. konkrete për ekonomi, për kulturë, për shkencë, për shëndet etj.

Për të ardhmen mjafton të mendohet dhe flitet më së shumti 15 përqind.

Nëse djali apo vajza e ofendon babën me fjalë të rënda, është ndonjëherë e padurueshme për prindin. Por, edhe fjalët ofenduese të babës ndaj fëmisë janë poashtu shumë të rënda.

Ai që flet dhe mendon me egoizëm dhe fanatizëm, nëse nuk i korigjon e nuk iu vë kufi atyre, pa e kuptuar të keqen, zhytet në të sa që nuk mund të dal fare. Nëse flet fjalë të matura nga vullneti i mirë, nga zotësia e sinqertë, kështu duke folur për ardhmërinë, padyshim, gradualisht pasurohesh me të mirat e natyrës.

Për mua personalisht, të flasësh ligësi dhe të mendosh keq është sëmundje ngjitëse nga e cila duhet të kujdesemi që të mos infektohemi.

Dua të them: Zoti mos ma mbushtë mendjen t'i bëj keq dikujt. E nëse dikujt i mbushet mendja të ma bëjë një dredhi, tradhëti gjegjësisht ndonjë të keqe kundër meje, le të urdhëroj, por le të ketë kujdes.

Unë mendoj, qëllimi është të mbetem si person i pastër në shpirt duke u varur prej

zotësive të mia. Dobësitë nga jasht unë duhet të mos i pranoj. Në këtë rast të këqijat që më sulmojnë nuk mundën të më bëjnë asgjë.

Po të bien në mua njëqind të mira, me lehtësi iu përballoj këtyre. Po të më bie një e keqe, mund të mjaftoj saqë mund të kemë edhe pasoja të rënda.

### **Kundër të këqijave duhet të kemi kujdes të veçantë.**

Nëse njeriu që nuk është i vetëdijshëm ta nis një punë praktike, ta bëj si duhet, ai është i dobët. Unë mendoj se duhet njeriu të tregohet i zoti e i kujdesshëm. Ndërkohë, vazhdimisht të krijoj ide për punë të reja e të përsosura. Qëllimi është që ne të jemë të zot ta fillojmë punën ashtu si është më së miri, kujdes shumë të vetëdijshëm, në këtë mënyrë mund të vazhdohet deri te suksesi i plotë.

Njeriu që e do natyrën, atë çka është e bukur, e mirë dhe që e do shëndetin, ajrin e pastër, shkencën, fitimin, autoritetin dhe humanitetin, ai do t'i gjej ato. Të

interesuarit për të mirat e natyrës, të bën të takosh (gjesh) gjithçka që kërkon. Mirëpo, edhe anët e kundërta nëse i kërkon, i takon.

Për ata njerëz me ide dhe dëshira të forta herët a vonë do t'u realizohen.

Mendimet pasive dhe sugjerimet negative njeriut i sjellin dëm aq sa i ushtron kundër vetvetës.

Të këqijat që të vijnë prej momentit të panjohur janë të dëmshme, por shumë më të mëdha janë dëmet të cilat vijnë prej të keqes që ia ke ndihmuar rastin.

Gjendjes së tashme, nëse është e kënaqshme ose e pakënaqshme duhet t'i kushtojmë rëndësi dhe kujdes të veçantë. Por gjendejes së tanishme në vazhdimësi t'i kushtojmë kujdes me përpjekje sa më përparimtare.

Nëse jipen dy urdhëra të kundërt për të njejtën punë, veçanërisht ne duhet të kemi kujdes ta njohim kuptimin e punës që duhet kryer.



Më mirë është të bëhet një pësim i vogël për të fituar një mësim të madh.

Dobësi do të ishte nëse e bëjmë një pësim madh për fitim të vogël.

Ai që bëhet nënë e ndonjë ideje e cila zbatohet në praktikë, atëherë kush na mbetet babai i saj?! Unë mendoj se është rezultati.

Atë çka po e shoh me sytë e mi, atë çka po e ndjej, atë çka po e dëgjoj, përjetoj, synoj, ëndërroj, atë çka më frymëzon, atë dhe këtë, thëniet dhe kundërthëniet, dyshimi dhe mendimi tek unë kanë një domethënie të madhe me arsye të përcaktuara. Krejt kjo bëhet për ta gjetur një mënyrë të qartë, si të shpjegohet, materializohet dhe të zbatohet sa më mirë praktikisht.

Idetë dhe dituritë tona nëse hutohemi e nuk e shënojmë atë çka e kuptojmë, atë çka e përjetojmë, do të bëhet një gabim dhe sherr i madh.

Ne jetojmë e udhëtojmë në ëndërr e zhgëndërr, për çdo punë shpenzojmë energji dhe kohë. Ndodh shpeshherë të njejtën udhë ta kalojmë disa herë. Detyrë e madhe është që sa herë e kalojmë rrugën, ta përcjellim me vëmendeje. Nëse këtë gjë e kontrollojmë me vetëdije, atëherë mund të pëfitohet diçka e re.

Nëse e dimë se e kemi një armik, ai natyrisht mund të na bëj dëm. Athua a duhet ta kemë parasysh se pakujdesi ynë mund të jetë armiku më i rrezikshëm?!

Për ne mbeten petkat e jetës dhe të suksesit kujdesi dhe interesimi i vetëdijshëm.

Kur bëhet fjalë për armikun apo kundërshtarin, a bën që ne të flasim e mallkojmë e të kalojmë në shkallën e urrejtjes e fanatizmit kundrejt armikut tonë?! Ne nuk bën të kundërvihemi në këtë formë sepse nëse e fitojmë një shprehi të dëmshme si: urrejtja, ankimi, mallkimi në këtë rast do ta mundojmë shumë vetveten.

Zgjidhjet e çdo problemi sa më të kulluara e të qarta që i kemi, rezultatet janë më pozitive.

Nëse e kemi një armik, më së miri është të flas shprehia e punëve tona dhe t'i kundërvihemi me forcën e vigjilencës, maturisë dhe mirëkuptimit tonë.

Nëse dijmë armikun ta luftojmë me mjete paqësore, bazuar në shprehitë e shkëlqyera, mund të kemi përfitime të dyanshme. Në këtë rast bëhet shpëtimi i robrisë së pakuptimtë të jonjerëzores. Në këtë rast, fjala armik kthehet në trajtën mik.

Frigohem që të jemë i friguar.

Jeta e njeriut përbëhet prej kohës, prej idesë, shprehisë dhe prej shumë rregullave tjera natyrore. Nga këto kompletohet njeriu. Intersimi me vetëdije është në këtë rast një gjë e varur për ne.

**Univers je ti, unë dhe të gjithë ne!**

Ai që beson në format e mashtrueshme, pa e hetuar mund të pësoj shumë rëndë.

Nëse beson duke i dhënë rast vetit që atë besim ta analizosh mirë, në këtë rast mund të mësosh diçka dhe të përfitosh.

A do të thotë se paraqitet rezultati i dëshiruar kur të duash ti?! Unë mendoj se jo gjithnjë, sepse varet prej rrethanave të shumta. Varet kryesisht prej kohës, nganjëherë edhe prej fatit.

Një rezultat të dëshiruar duhet ta bëjmë me maturi dhe vullnet të vazhdueshëm. Gjithnjë përfitojmë nga gjërat e reja dhe mësimet do të duken të thjeshta, të lehta, të qarta, reale dhe të dashura.

Ne jemi robër të së vërtetës konkrete. Po nuk e dëgjuam atë, natyrisht se ajo do ta bëjë të vetën.

Sa herë të mendosh e të interesohesh për ndonjë gjë të re, ke ide apo fantazi, kjo punë është shumë e mirë. Këto virtyte të mira si dëshironi t'i materializoni? Unë mendoj në këtë rast duhet të jemi llogaritës të mirë dhe kërkesat tona të jenë shumë të vetëdijshme.

Idetë dhe dëshirat realizohen nëse i planifikojmë me kujdes ku do të na duken thjesht, saktë dhe qartë.

Është punë shumë me vend dhe maturi e pësosur kur vet ti personalisht me një intersim të rregullt e përcjell me vetëdije çdo proces të zhvillimit fizik e psikik. Çdo moment që e përjeton, çdo shprehi të krijohet prej rastit dhe qëllimit. *Në këtë rast vetëdija është udhëheqësja kryesore e jetës sonë.*

Shprehia është ndikim në çdo zbatim të veprimit.

Çdo punë dhe veprim që e bën shprehia kultivohet si gjest frytëdhënës, si pozitivisht, ashtu edhe negativisht.

Kujdesi, sugjestionimi (autosugjestionimi) janë pjesë përbërse të vetëdijës, respektivisht shprehisë.

**I frigohem të së kaluarës, i besoj të tashmes, dyshoj në të ardhmen.**

Dikush e bën jetën në formën e llogaritjes plus ( $10+10=20$ ), e dikush mund ta bëj jetën në formën e shumëzimit ( $10 \times 10=100$ ). Por ka edhe njerëz që e bëjnë jetën me minus.

**Të këqijat e së kaluarës nuk përmirësohen, por përmirësohen vetëm nëse harrohen.**

Të gjitha mendimet, veprimet planet, fitimet, zbulimet dhe çdo perspektivë e ka vlerën e vet. Duhet të mendojmë patjetër si t'i mbrojmë këto sepse mund të rrezikohen nga dredhitë e dikujt tjetër.

Varfërisë duhet t'i frigohemi më shumë se djallit.

Ai që e don vetminë, le ta dojë edhe diturinë.

Ta mësojmë veten që të mësohemi me mësimet e mësuara dhe të pamësuara.

Sa më shumë syçeltësi, aq më pak ka humbje.

Sa më të kuptuar, aq më të bashkuar. Sa më të pakuptuar, aq më të copëtuar.

Robërinë nëse e luftojmë me mjete paqësore, si e quajmë? Fitore në ëndërr ose humbje në zhgëndërr.

**Politikisht nuk i frigohem asnjë shteti (populli), se sa i frigohem popullit tim nëse është i padijshëm.**

Njerëzit e pakuptueshëm dhe të pagjykuar nga vetvetja nuk binden me marrëveshje e as me dialog, por binden me dhunë ose me forcën e nënshtrimit.

T'i zgjojmë ndjenjat, reflekset, kujdesin, interesimin, dashurinë me vend dhe qëllimet e caktuara, vetëm e vetëm që të jemi më aktivë, më të gjallë, më të lumtur, më të fituar dhe më të përparuar.

Më e keqe është të jeshë në dy robëri, i sunduar nga dhuna e dikujt dhe i sunduar prej mosmarrëveshjes e mosditurisë tënde.

**Të mirat e të së kaluarës mund të përmirësohen dhe të rindërtohen. Nuk mjafton të mbeten ashtu si janë.**

Marrëveshja familjare dhe kombëtare e mund çdo dhunë të huajën.

Mendimet e vogla nëse zhyten në mendime të mëdha, ato zbërthehen në to.

Nëse mendimi i madh zhytet në mendimin e vogël, do të humbet vlera e tij.

Një punë që e nis me kundërshtimin e dikujt tjetër, mund të jetë e paqartë ose e pavlershme për të. E nëse ajo punë është përfunduar me sukses, mund të ndodhë që të jetë e pëlqyer nga ai i cili e ka kundërshtuar më parë.

Të mirave të papritura shpeshherë njeriu nuk ua din vlerën. Të mirave të mundimshme ua din vlerën më shumë.

Një ide që shënohet, është më e vlershme se njëmijë ide të folura.



Një ide e shkruar, nëse përfundohet në praktikë, është më e vlershme se ajo e shkruar.

Në kohën e tashme nuk ta zgjidh problemin as fjala e as autoriteti, sa ta zgjidh forca dhe vendosmëria jote.

Për ta sunduar shekullin njëzetentjës, sëpari atë duhet ta njohësh, duhet ta duash dhe ta kuptosh vetveten.

Edukata është pjesë e jetës, kulturës, moralit, dijes, sjelljes, dialogut dhe mirëkuptimit.

**Të kritikosh është vonë, të këshillosh është herët, të edukosh është kohë e volitshme.**

Të kritikosh don të thotë fyerje, me një aspekt grindje, rrallëherë e ka vlerën e vet pozitive. Është shumë lehtë të kritikosh e të gjendet shkakut për ta kritikuar dikë.

Të këshillosh është poashtu lehtë, por jo më lehtë se të kritikosh. Të këshilloj mundet çdokush, prandaj këshilla mund të jetë si

presion dhe i tepërt, si detyrim pa vullnet me kuptimin e dhunës. Për këtë shkak edhe këshilla vështirë kuptohet.

Fjala edukatë është e madhe, është e llojllojshme, kjo përfshin shumë virtyte dhe aktivitete të njeriut. Të jeshë i edukuar mirë don të thotë të jeshë më i vetëdijshëm dhe më i lirë. Edukata poashtu don të thotë i përparuar, i fituar, i harmonizuar, i shëndoshë dhe i lumtur.

Të edukosh veten apo dikë tjetër në njëfarë mënyre ai person bëhet i përsosur.

T'i jipet dikuj edukatë, kërkohet dëshirë, qëllim me vend, koncentrim dhe interesim.

Të jeshë i disponuar don të thotë të jeshë i freskët, të jeshë i lumtur don të thotë të jeshë i qetë.

Tipat njerëzve në tri grupe:

**1.**

- ta ruash atë çka e ke, të dish si ta mbash.
- të kultivosh, të krijosh gjithçka që është e arsyeshme dhe e rëndësishme

- të shfrytëzosh gjithçka që krijon nga duart tua

2. Në këtë grup marrin pjesë ata njerëz të cilët:

- sëpari shfrytëzojnë atë çka kanë
- shfrytëzojnë atë që e krijojnë
- e mbajnë atë çka kanë

3. Në grupin e tretë janë ata tipa njerëzish të cilët:

- e mbajnë atë që e kanë
- shfrytëzojnë
- krijojnë

**Më produktive është mbaj, krijo, shfrytëzo.**

Edhe të mirat që të vijnë prej momentit nuk janë aq të vlefshme, të cilave ua mundëson rasti.

**Ka një tip njerëzish që jetojnë nga të menduarit (kujtuarit). Të tillët e kanë jetën shumë të vështirë.**

**Tipi tjetër jeton nga të studiuarit (vrojtuarit). Këta njerëz e kanë jetën shumë të suksesshme.**

E mira dhe e keqja përbëhen prej ligjeve natyrore të njejta si p.sh. kur fillon të ndritet shkon gjithnjë e më shumë të ndritet. Kur fillon të errësohet, shkon gjithnjë e më shumë duke u errësuar.

Njerëzit e pavarur dhe të vetëdijshëm kanë aftësi marrëveshjeje me njerëz të tjerë dhe aftësi të bashkëpunimit.

A e dini ç' do të thotë një dhuratë e vogël për një ndihmë të madhe, apo një dhuratë e madhe për një ndihmë të vogël?

I paedukuari që të edukon është dëm dhe shumë me rrezik.

Nuk ke të drejtë të nervozohesh me dikë nëse nuk e ke të qartë vetveten.

Nuk ka nevojë që njeriu të mërzhitet për dobësitë e tjetrit por të mërzhitet për dobësitë e veta.

Gabimin që e mbulon gabimi, është për t'u vajtuar.

**Në kohën e tashme tenton gjithnjë e ardhmja. Ne duhet të mundohemi gjithmonë ta vrojtojmë dhe përjetojmë të tashmen me ndjenja, emocione, dashuri, frymëzim e harmoni sepse e tashmja është gjithçka dhe mund të thuhet materialiste. E ardhmja dhe e kaluara janë idealiste apo si një lloj ëndrre.**

Liria e çdo populli është e mbështetur në komunikimin harmonik të kuadrove profesionale (universale).

Nëse do që një gjëje t'ia ngrisësh vlerën, ruaje mirë, çmoje si tejet të dobishme dhe mos e huazo shumë se ta dobësojnë të tjerët.

Gjërat politike duhet të ruhen dhe të përdoren sekret, sidomos planet dhe idetë e ardhmërisë, të ruhen si ide e fshehtë dhe ndërkohë të punohet haptas.

Njeriu i cili i ka disa probleme të pazgjidhura agresionet e veta mund t'i shpreh në mënyrën më të ashpër, sidomos në momentet e një nervoze në rast të ndonjë konflikti. Nëse qëllon një person në këtë moment, drejtpërdrejt agresionet zbrazen kundrejt këtij personi.

Jeta është e zhytur më shumë në mendime e më pak në fjalë. Mendimet janë të shumëllojshme e fjalët të pakllojshme.

Ai që vonohet, duhet të ngutet.

Njeriu duhet të dij ku ta koncentroj kohën kryesore:

- në drejtimin profesional 70-80 %
- në drejtimin joprofesional 20-30%

Nëse mendoni se punët precize mund t'i kryeni shumë shpejt, e keni gabim, sepse në punët precize duhet të keni kujdes të veçantë.

**Veprimet e përditshme dhe obliguese si p.sh. veshmbathja, ngrënia, shëtitja, pushimi, nuk bën as këto të bëhen me**

## **shpejtësi sepse këto veprime kemi nevojë t'i shijojmë dhe të relaksohemi me to.**

Me shpejtësi mund t'i kryejmë vetëm punët e rrezikut, sepse në këto raste nuk premtan koha.

Në çdo veprim dhe studim duhet ta respektojmë koncentrimin dhe vrotimin, sepse në këtë rast përfitojmë jo vetëm diturinë e pastër por edhe do ta kemi gjendjen psikike dhe fizike më të shëndoshë.

Ai që do shëndet të mirë psikik dhe fizik, duhet të jetë më energjik dhe dinamik gjatë veprimit të detyrave të parashtruara.

Diturinë duhet ta kuptojmë kështu: interesim-koncentrim; mbajmend-shpjego; analizo çdo gjë dhe kaloje në shprehi.

**Mendimet e zbrazëta e pengojnë rrugën e suksesit dhe ardhmërisë tënde.**

**Shumica e njerëzve e zhvillojnë diturinë e tyre përmes mendimeve, ndonjëherë mendimet e tepruara kalojnë në ëndrra**

**të tepruara. Nëse në këtë mënyrë e zhvillojmë diturinë, kjo don të thotë dituri e sëmurë dhe e gjymtë.**

Nëse mendojmë se djalli është më i fortë se njeriu, duhet të mos harrojmë se forca kryesore e njeriut është inteligjenca. Intelejenca është fuqi kozmike.

Është lehtë të mësosh, të fitosh, të bëhesh i lumtur dhe i shëndoshë, por shumë vështirë është t'i përmirësosh gabimet.

**Dëshirat që i kërkojmë janë të mbështetura në shpirtin tonë.**

Shpeshherë të mirat dhe të këqijat vijnë në mënyrë indirekte.

Plotësoja shpirtit dëshirën e mirë, sepse shpirti do ta plotësoj edhe më të mirë.

Besoj asaj që e do si p.sh. shëndetin dhe diturinë.

Ata që janë jopunëtorë nuk mund të jenë shpirtmirë.



Ata që kanë mungesa dhe dobësi personale, shpeshherë mundohen të tjerët t'i edukojnë.

Ka njerëz ku dredhia e tyre është më e përsosur se dituria e tyre.

Dredharakët shpeshherë kanë më shumë sukses se personi që është korrekt.

Dituria e dredharakut ka sukses duke i mashtruar të tjerët.

Nëse di të bësh dialog me rrethin tënd ku jeton, din të bësh dialog edhe me armikun.

**Njeriu mund të ketë vetëbesim atëherë kur është duke mësuar vazhdimisht gjëra të reja.**

Ai që është intelgjent, e ka shumë lehtë prej atij me më pak intelgjencë që të mësoj si nga dobësitë, ashtu edhe nga të mirat e tij.

Bëhu së pari zot i vetvetës, atëherë do ta dish se çdo të thotë fjala Zot.

## **Duhet t'i besohet vetëm atij të suksesshmit.**

Ai i cili nuk është në gjendje të bashkëpunoj me ty, është në gjendje të të kritikoj dhe të të fyej.

Ata të cilët në çdo bisedë janë provokatorë, nuk kanë ndërmend që të bëjnë dialog e as të mirren vesh me ty.

Kokëfortit nuk e pëlqejnë askënd dhe nuk i besojnë askujt.

Çdo frikë ndikon në dyshim dhe humbet kontrolli. Frika në këtë rast të detyron të besosh në mënyrë të gabueshme.

Mërzia dhe brengosja e dëmtojnë shumë gjendjen shpirtërore. T'i largohesh këtij rreziku duhet të jeshë vrojtues për çdo situatë që e ke parasysh, me durim dhe interesim të sinqertë

Ai i cili di të pyet, di shumë mirë të përgjigjet.

Ai që di të dëgjojë, di shumë mirë të këshilloj.

Ai i cili i pranon kritikën, di shumë mirë ta edukoj dikë tjetër.

Luani duhet të mbetet luan, maca le të mbetet mace!

Ata të cilët janë të pakënaqur me vetveten, hetohen në të folur: përqeshin të tjerët, fyejnë, mallkojnë dhe për çdo gjë janë të ndieshëm.

Ai që është i lumtur me vetveten, nuk e dëgjon asnjëherë duke fyer dikë apo duke e përqeshur.

Hutia manifestohet me përtaci.

Përtacia manifestohet me nxitim, ku nxitimi do të thotë stres.

Sa më shumë që kemi aftësi të të shprehurit, më lehtë e kemi për të komunikuar në mesveti.

Aty ku dominon urrejtja, dyshimi dhe xhelozia, nuk ka vend dashuria.

Nëse është shumë vështirë të zbulosh diamant, poashtu është vështirë të gjesh njeri të mirë.

Është shumë mirë kur qeshemi me zemër. Kjo qeshje shëron edhe plagët më të rënda psikike dhe fizike.

E qeshura artificiale dhe jo e dëshiruar të harxhon shumë energji, ta dëmton shëndetin dhe ta dobëson shpirtin.

Medimet që jipen me urrejtje, mund ta sëmurin edhe njeriun më të fuqishëm që ekziston.

Ata të cilët nuk kanë dituri të mjaftueshme, nuk dijnë të mirren vesh në mesveti, diktatura do të bëhej ilaçi më i mirë i tyre.

Komplekset paraqiten tek njeriu atëherë kur fillon ta humb origjinalitetin e vet.

Edhe ai i cili është i hutuar ka në vete komplekse shumë të dëmshme.

Në njëfarë mënyre komplekset mundemi t'i largojmë nëse dijmë punët tona t'i kryejmë (bëjmë) me seriozitet.

Ata të cilët e humbin besimin në vetvete, bëhen viktimë e çdo dobësie që i kanoset. Në këtë rast, beson lehtë dhe gabueshëm.

Ai person që flet me zë të ulët, të dyshimtë dhe joqartë, shumë lehtë kuptohet se është me komplekse të rënda.

Njerëzit të cilët dijnë të kuptohen në mesveti, mund ta formojnë shoqërinë e përsosur.

Nëse mungon njohja e organizimit të shoqërisë njerëzore, dijeni se kjo shoqëri është nivel shumë i ultë njerëzor.

Ata të cilët dijnë të bëjnë organizime në shoqëri dhe rreth ku jetojnë, e ngrisin kulturën dhe zhvillimin e shoqërisë.

Çdo njeri e përmban në vete një fshehtësi, por secili e njeh atë në mënyrën e vet.

Ta sulmosh armikun dhe ta mbrosh është më vështirë se ta sulmosh dhe ta asgjësosh.

Shpeshherë ndodh, ne nuk dijmë t'i shfrytëzojmë rastet që na u kan dhënë dhe më vonë na bie ndërmend.

Zakonisht ndodh kur dikush ua sheh sherrin gabimeve dhe dobësive të veta, dhe shpeshherë disa ia shohin sherrin mirëqenies së tyre.

Ai që di ta zgjedh shoqërinë e mirë mund të jetë shumë i suksesshëm.

Disa njerëz dijnë ta përcjellin me vëmendje gjendjen e të tjerëve, ndërsa veten nuk e njohin fare.

Koncentrimin sidomos në dëgjim duhet ta kemi edhe atëherë kur flitet kot, keq ose mirë. Kuptohet pra, koncentrimin ta kemi në çdo situatë aktiv.

Sa më me kohë të volitshme i mësojmë gjërat, jemi më të lumtur, më të sigurt dhe jetën e kemi më të qartë.

Gjithnjë duhet me qenë në diçka fitues ose mbisundues.

Të ndërtosh diçka ose të bësh çka nuk e ke besuar, do të kesh forcë më të madhe për sukseset e mëtutjeshme.

E ke qëllimin e mirë për ta bërë një punë dhe të duket e mundimshme, atëherë mësohu ta kuptosh më qartë dhe në këtë mënyrë do ta keshë më lehtë suksesin.

Pse duhet veprimet tona t'i bëjmë sa më të përkryera? Sepse gjithnjë ne mësojmë gjëra të reja.

Sa më pak të bëjmë gabime që të mos kemi pengesa dhe shqetësime.

Në rrethin e panjohur nuk është mirë që menjëherë të flasësh rreth çështjes tënde.

Mos u mëso asnjëherë që ndonjë bisede ose pyetje t'i përgjigjesh pa e kuptuar mirë.

Pse streset të bëjnë nervoz? Sepse ato fitohen prej hutisë, mospreçiziteteve dhe përtacisë.

Truri i njeriut varësisht nga orientohet, poashtu koncentrimi drejtohet në atë mënyrë duke u manifestuar me rezultate të mira apo të këqija.

Tradita e forcon mendimin kolektiv dhe e izolon diturinë.

Ato mendime të cilat bëhen më së shumti me dashuri, arrihet rezultati më i mirë.

Çështja emocionale e njeriut sa është e këndshme, aq mund të jetë e dëmshme.

Emocionalisht mund ta duash të dashurën ose fëmijët e tu, por mundësisht emocionet nuk përdoren aty ku ka edukatë ose diplomaci.

Ndikimeve emocionale nëse iu nënshtrohet njeriu, është e njëjta gjë sikur të jetë i dehur ose i droguar.

Sa më shumë që di, aq më të lehta të duken detyrimet e përditshme.



Superprofesionalizmi është i domosdoshëm sepse e shpëton jo vetëm personalitetin por edhe shtetin.

Shpëtimtar i popullit është ai njeri i cili lufton dobësitë e veta dhe fiton aftësi të larta profesionale.

Të të menduarit e një gjëje pa e studiuar mirë, të bën që të duket vetja se di shumë. Në të vërtetë dituri është ajo e cila i analizon dhe i studion gjërat mirë.

Nëse i nënshtrohesh propagandës së një besimi, atëherë iu ke dorëzuar mendimeve të kota.

Idealistët mendojnë se dijnë shumë dhe iu besojnë ëndërrave të tyre, jetojnë me to dhe që të gjitha këto nuk janë të të aftë që t'i vërtetojnë në jetën e tyre praktike.

Nëse dëshiron ta zgjidhësh një problem shpejt, së pari duhesh ta gjesh problemin kryesor, pastaj mund t'i zgjidhësh edhe problemet më të vogla.

Me personat emocionalë lehtë mund të manipulohet. Ai i cili don këta t'i keqpërdor, i ngacmon emocionalisht qoftë për të mirë ose për të keq.

Nëse don që punët të shkojnë mirë, bëj ato pa stres dhe me disponim të mirë, ku në këtë kohë je edhe sundues i mirë. Nëse ke stres dhe disponim jo të mirë në punë, tërë koha që e bën të duket e vështirë dhe e komplikuar.

Të bësh diçka për vete don të thotë se je dikushi, e të flasësh për vete don të thotë se je askushi.

Njeriu i grupit të thjeshtë flet për vete.

Fjalët e mira dhe mendimet e këqija nuk sjellin kurrfarë dobie.

Po fole mirë, mendo edhe mirë.

Atë që mundesh vet ta mendosh, mos e pyet askë. Atë që nuk e kupton, pyete dikë.

Çdo iniciativë e re, e ka një fazë kalimtare.

Një iniciativë e përfunduar me sukses,  
është më e madhe se iniciativat e  
papërfunduara.

Dy mendime në të njejtën kohë nuk bën të  
gjejnë vend në kokën e shëndoshë.

Mendimet e prera janë të qëlluara.

Atë që e dëshiron dhe je i sigurt në të,  
mendoje më shumë.

Mendimet e mira nënshtroja qëllimit të  
mirë.

Pse duhet çdo veprim të bëhet perfekt, në  
mënyrë të përkryer? Sepse tani gjithnjë  
mund të mësojmë gjëra të reja.

Nëse e lejojmë veten të bëjmë gabime, jo  
vetëm që kemi shqetësime, por kemi edhe  
pengesa të mëtutjeshme.

Ai që don ta zgjidh problemin, duhet ta  
ndryshoj mendimin dhe kohën kryesisht ta  
shfrytëzoj për qëllime të mira.

Nëse do ta ruash shëndetin, ndieje veten mirë; nëse e do jetën, largoju vajtimeve dhe zemërimeve të ndryshme.

Shpeshherë ndodh, më mirë është diçka e keqe po e re sesa e mirë dhe e vjetër.

Të jeshë i koncentruar në këshillë harxhon më pak energji, sepse je i koncengtruar vetëm në një pikë. Është pra më lehtë dhe më e dobishme.

Vullneti i dobët shkakton pasoja të rënda në lëvizjen normale, bën dëm në trupin fizik dhe psikik.

Nëse lëndohesh në këmbë, të mungon vullneti i ecjes së mëtutjeshme. Nëse je i dëmtuar në buzëqeshje, të mungon dashuria.

Mendimet e tepruara janë ëndërra syhapur, e shkatërrojnë sidomos koncentrimin dhe vetëdijën.

Në jetën e përditshme na nevojiten informacione të sakta dhe të qëlluara.

Ëndërrimet nuk ndihmojnë asgjë, por shumë dëmtojnë.

Jetën e ke më të gjatë nëse e ke të zbukuruar me humor dhe lumturi.

Jetën e ke shkurtuar nëse i lejon mërzitë ose nervozat e ndryshme.

Nëse do që të dashurit e tu t'i keshë sa më afër, thuaju gjëra të bukura dhe kujtime të mira.

Mos bëj asnjë punë pa dëshirë dhe pa qëllim të mirë. Nëse don të jeshë i suksesshëm, bëj ato me vendosmëri.

Para se të filloni ta kryeni një punë, bëjeni edhe organizimin e mirë. Mos llogaritni vetëm në fitim, por llogaritni edhe humbjen apo dështimin. Kurrë mos lejoni të ndërhyjnë emocionet përveç diturisë.

Njëanshmërisë shpeshherë i mungon diçka dhe paraqet rrezik.

Edhe njëanshmëria pozitive apo negative sa është e mirë, aq është edhe e keqe.

Nëse je i koncentruar në një shikim, e shikon atë çka e ke menduar më së shumti deri në momentin e fundit.

Gjatë tërë ditës çka ke menduar, të paraqitet parasysh dhe sheh ashtu siç ke menduar.

Kur t'i shikosh figurat, fantazon dhe imagjinon ashtu si i ke mendimet.

Anën e kundërt e mund çdo gjë nëse i shtohet masa tjetër më e madhe se ajo.

Nëse e ke një qëllim me rëndësi, mos dysho fare në të.

Nëse në qëllimin e mirë ke dyshuar, ia ke humbur vlerën.

Shpeshherë kur flitet drejtpërsëdrejti, edhe pse është për qëllim të mirë, mund të merr kahje të gabuar.

Shpeshherë edukata dhe këshillat e mira, në mënyra indirekte japin rezultate më të mira.

Duke u munduar ta ndryshosh dikë tjetër,  
në të njejtën kohë mund ta ndryshosh edhe  
vetveten.

Mashtruesi kundër jush i përdor pikat më të  
ndieshme, të jep premtime derisa në njëfarë  
mënyre të hipnotizon.

I vërteti gjithnjë kërkon t'i zbuloj  
premtimet e dëshiruara.

Çdo përgjegjësi e don angazhimin  
maksimal.

Idetë e zbatuara tregojnë sukses, idetë jo të  
zbatuara zakonisht krijojnë huti.

Në gjendje jo të disponuar nuk është mirë  
të bëjmë plane sepse mund të kemi pengesa  
të mëdha.

Në çdo lëvizje të jetës sonë mund të  
mësojmë gjëra të mëdha.

Shumë njerëz mendojnë se është e njehta  
gjë atë çka e mendojnë dhe atë çka e dijnë;  
ndërsa, të mendosh është si nata, të dish  
është si dita.

Shpeshherë njerëzit e pakuptueshëm  
tentojnë të të këshillojnë dhe kjo është e  
dëmshme.

Është më lehtë ta bësh një çudi botërore se  
sa ta edukosh një kokfortë.

Situata krijohet sipas momentit të  
ndjeshmërisë si dhe sipas kohës së  
pregaditur.

Çdo problemi i duhet koha e veçantë dhe si  
e krijon situatën, ashtu edhe e ndien  
vetveten.

Përvoja sa më e mirë, e qartë, krijon trimëri  
më të sigurtë.

Duhet që të kesh kohë mendimin ta  
studiosh mirë e sigurt.

Paratë shkojnë tek njerëzit që dijnë t'i  
shfrytëzojnë ato.

Profesionalizmi dominon në para, kulturë  
dhe pushtet.



Nëse e di se nesër duhet ta bësh një punë në një kohë të caktuar, kurse sot sidoqoftë duhet të jeshë i kënaqur me qëllimin se do të jeshë gjithnjë i parapregaditur për punën që vjen.

Njerëzit që nuk janë të aftë t'i praktikojnë gjërat e ditura, thjesht frymëzohen nga ato që i dijnë më së shumti qoftë për të mirë a për të keq.

I hutuar e i pasigurt don të thotë të jeshë shumë i varur nga të tjerët.

**Të jeshë i pavarur don të thotë vetëdije për një ardhmëri më të mirë, i papenguar nga të tjerët dhe i fituar nga aftësitë që i ke.**

Nëse mundohesh të jeshë dominant pa aftësinë e pavarësisë dhe të vetëdijës, në këtë rast mund të keshë forcë të vetëshkatërrimit.

Bëhuni të pavarur dhe të vetëdijshëm, të jeni më dominant në çdo sukses, sepse në këtë rast forcën fizike dhe psikike e keni nën kontroll.

Ai që ka aftësi të pavarësisë dhe vetëdijës, dominon dhe krijon zhvillim e kulturë të mirëfilltë.

Nëse intelektualët kanë dhënë formula të përgjysmuara apo vepra të përgjysmuara, kanë bërë punë djallëzore.

Gjërat e paramenduara qoftë për të mirë apo për të keq duhet t'i keshë gjithnjë nën kontroll. Mendo mirë për të ardhmen, por në mënyrë të organizuar dhe në këtë rast do të duken se gjërat vetvetiu shkojnë mirë.

Beso në atë çka e do apo në atë çka duhet besuar.

Nëse beson nga frika, atëherë do ta rrisësh atë problem pa e gjykuar mirë sa duhet, dhe kjo manifestohet me rezultate negative.

Një gjë që të paraqitet e është negative, jo e dëshirueshme, në moment të shpejtë duhet këtë veprim ta shëndrrojmë në veprim pozitiv.

**Profesionalizmi e sundon botën.**

Nga moskujdesi dhe nga mosdija shkaktohen shumë gabime, ku do të bëhen pastaj ngarkesë psiqike, si p.sh. shkaktojnë nervozë dhe telashe të dëmshme. Gabime të tilla e pengojnë zhvillimin normal të jetës.

Gjithnjë e më shumë informacionet dhe mendimet e reja zënë vend dhe gradualisht ngushtohet hapësira në trurin tonë. I vetmi shpëtim mbetet që vazhdimisht informacionet të jenë sa më të seleksionuara apo të nevojshme (të arsyeshme).

Fati i popullit tim është në duar të miat dhe tuajat!

Përvjeli duart tua dhe çdo punë të mundshme apo të pamundshme do ta kryesh me sukses!

E sotmja nga e kaluara për të ardhmen tonë!

Të keshë vizion don të thotë ta përcjellësh atë si nëpër binarët e trenit dhe të shkosh

mbas vizionit, në këtë rast çdo hap do ta përcjellësh në kohën e sotme.

Ajo çka ndodh sot është e shkaktuar nga mendimet e së kaluarës.

**Për çdo gjë duhet të parapregaditemi me mendime të shëndosha për një të sotme të mirë, nga e kaluara për të tashmen përmes së ardhmes.**

E kaluara është programi i së tashmes.

E tashmja është rast, moment, dhe fat i mbarë nga e kaluara.

E ardhmja si vizion ëndërr apo qëllim i ndihmon të sotmes.

Kur ta mendojmë të ardhmen, të kaluarën e lëmë gjithnjë në bazë të pregaditjes praktike. Të sotmen vetëm e përjetojmë ashtu si jemi pregaditur më herët dhe na duket se çdo gjë është duke na i ofruar fati apo rasti.

Duhet të tentojmë të jemë dominantë ndaj kohës së tashme, çdo gjë është herët ose

vonë, disi nuk i përgjigjet qëllimit, rastit apo fatit. E sotmja është kufiri në mes të kaluarës dhe së ardhmes.

**Më e rëndësishmja është e sotmja, prandaj vetëm atëherë jemi të qetë, të lumtur, të dashur, të durueshëm, të matur dhe pikërisht për këtë mund të jemë dominantë ndaj kohës.**

**Vetëm në kohën e sotme mund të shijojmë, dashurojmë dhe përjetojmë. Ky rast na tregon se jemi më dominantë edhe ndaj të kaluarës dhe të ardhmes.**

Mençurinë tënde të dish ta shprehësh e të komunikosh me njerëz jo të pjekur është shumë vështirë. Në këtë rast dija jote në mesin e këtyre njerëzve mund të ketë vlerë rreth dhjetëpërqind. Kurse në mesin e intelektualëve, dituria jote mund të ketë vlerë edhe njëqindpërqind.

Forcat e errëta që quhen, ato kurrë nuk zbatohen në opinion si e pabesueshme, por kryesisht janë si pasojë që vjen nga mosdija.

Dituria jo e përkryer mund të quhet forcë e errët sepse është e dëmshme.

Një vazhdimësi e çrregullt pengon vazhdimësinë e rregullt.

Nëse e mëson gjumin e keq, trupi fillon të mos e njoh gjumin e mirë.

Nëse jonormalet na përcjellin në vazhdimësi, atëherë ato që janë normale fillojnë të na duken jonormale.

Në manifestimin e vetive të dobëta, mund të na bëhen të panjohura vetitë e shëndosha.

Shpirti i një krijimtari të shëndoshë duhet ta ketë një bërthamë të formuar mirë dhe të plotë.

Një e filluar jo aq e përpunuar nuk ka aq vlerë sa do të ketë kur të përpunohet mirë e më mirë, ku prej pak gjëje mund të bëhet shumë punë e madhe.

Nëse masat e mëdha janë të domosdoshme për një vazhdimësi, atëherë duhet filluar me

një bazë shpirtërore edhe më të vogël nëse është nevoja, por le të jetë e shëndoshë.

Fjalët e tepruara ia humbin vlerën vetes tënde, kurse puna apo vepra e shëndoshë e ngrit vlerën tënde.

Dituria e mirë nuk i shërben gjithkujt për të mirë sepse disa tipa të njerëzve dijnë vetëm ta keqpërdorin atë.

Dituria e shëndoshë duhet vetëm t'i bashkoj njerëzit e shëndoshë.

**Satanizëm nuk ka, por ka dobësi shpirtërore të njerëzve dhe dashuri të rrejshme.**

Aty ku ka potencial ekonomik, ka politikë të fortë. Potenciali ekonomik është forca kryesore e një shteti.

Mashtruesi shpirtlig shpeshherë duket shpirtmirë e i ndershëm. Dituria e këtyre njerëzve varet në bazë të dredhisë që e kanë.

Mashtruesi do të ketë punë me ty vetëm në bazë të ndonjë dobësie që e ke.

Gjërat e natyrshme sado që të bukura janë, nuk mjaftojnë nëse ato nuk dimë që t'i shijojmë.

Unë me vetveten nuk kam problem, por problem kam me të tjerët, me rrethin ku jetoj.

Për fat të keq shumica e njerëzve problemet kryesore i kanë me vetveten.

Je i rrezikuar nga e keqja atëherë kur momentet tua janë të dobësuar.

E keqja vjen nga momentet e gjendjes së dobësuar.

Ai që shet patriotizëm, është i dëmshëm për kombin.

Projektimi i një qëllimi apo dëshire varet në njëfarë mënyre edhe si mendon. Nëse je i disponuar mendimet dhe planifikimet realizohen në bazë të momentit të disponuar.



Mendimet që shfaqen me egoizëm ose me frikë, rezultatet do të jenë të dëmshme.

Një ndodhi e keqe nëse interpretohet me qëllim të keq, kuptohet vetëm për të keq. Nëse ndodhia e keqe interpretohet me qëllim të mirë, sadopak mund të ketë kuptim të mirë.

Kur jemi të koncentruar në një planprogram të caktuar, duhet të kemi kujdes nga ndërhyrjet e jashtme sepse mund të na e largojnë vëmendjen nga qëllimi ynë.

### **Perfeksioni qëndron mbi kohën.**

Perfeksioni dhe precizioni nuk i nënshtrohen kohës, sepse punët e kryera si duhet nuk humbet kohë që të bëhen përsëritjet e tyre.

Nëse është diçka e qëlluar, nuk është me rëndësi sa e vogël është.

Një pushim apo lëvizje e shkurtër don të thotë fillimi i saj.

Një ide e mirë por e vogël don të thotë fillimi i saj.

Një fillim i mbarë mund ta ketë një nismë të sigurt ose një sukses të sigurt.

Nëse i beson intelegjencës tënde, atëherë provoje atë duke e zbatuar me punë e jo me fjalë.

Mirë është të keshë dije të shëndosha në kokë, por më së miri është t'i zbatosh ato në praktikë.

Më mirë është që fëmisë t'ia japim një detyrë të mirë se sa dhjetë këshilla të mira.

Dituria e shëndoshë të ndihmon të jeshë organizativ dhe dominant. Ai i cili nuk i ka këto, mund të keqpërdoret edhe nga personi më i ultë.

Ai i cili arrin sukses me forcat e veta, nuk i duhen lëvdatat nga të tjerët.

Nëse masat e mëdha janë të domosdoshme për një vazhdimësi, atëherë duhet filluar me

një bazë shpirtërore duke u bazuar në vullnet të mirë.

Mendimet e planifikuara të ndihmojnë që t'i zgjedhësh problemet më mirë, më shpejt dhe më saktë.

Religjioni jo i mirë bazohet shumë në mendimet e pavërtetuara.

Ata të cilët i frigohen Zotit, nuk janë në rrugën e drejtë të besimit.

Ata që frigohen djallit, janë në rrugën e çmendurisë.

Mendjelehtësia e disave e dëmton religjionin.

Njeriu duhet të ketë më shumë kohë të mirret me organizim, sistemim se sa të mirret me disa probleme të kaluara.

**Nuk bën të mirremi me problemet që të pengojnë por me zgjidhjet e tyre.**

Nëse je në rregull, mjafton t'i besosh vetvetes.

Përgjegjësia ndaj vetvetes është kryesorja.

Organizimi-mosnjohja e tij është sëmundje mentale dhe shpirtërore. Njohja e organizimit është lokomotivë e jetës në përgjithësi.

Aftësitë organizative e shpëtojnë individin, shoqërinë, kombin dhe njerëzimin.

**Njohja e organizimit është fuqia e gjithësisë në vet njeriun.**

Njohja e organizimit është talent, vullnet, dëshirë, motivim dhe gjithçka më pozitivja në jetën e njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi.

Njohja e organizimit ta mbron familjen, kombin dhe njerëzimin.

Mosnjohja e organizimit është niveli më i ultë i individit, i familjes, i kombit dhe i njerëzimit.

Një perfeksion apo një precizion i ushtron aftësitë tua superiore.

Për mua njerëzit superiorë janë hyjnorë.

Realiteti është shprehja e të përkryerës dhe perfeksionit. Precizioni dhe perfeksioni është vetëm një realitet.

Për të arritur një dije të shëndoshë duhet t'iu nënshtrohemi njohurive të sakta.

Një program i shëndoshë të qon në suksesin e shëndoshë.

Edhe nga dija e fituar nëse është e vjetruar, duhet të kemi kujdes. Ndoshta me dijen e vjetëruar nuk mund të përparojmë.

**Duhet të kemi kujdes nëse kemi dije të vjetëruar.**

Ai i cili i pranon si të mirat ashtu edhe të këqijat në një mënyrë të qetë, do të arrij që të jetë më i lirë shpirtërisht dhe problemet e paraqitura mund t'i zgjidh pa vështirësi.

Kontrolloje mendimin dhe dijen që e ke, përpunoje, dirigjoje sipas suksesit dhe qëllimit të dëshiruar.

Të keshë vizion ka rëndësi të veçantë kur studiohet, shkruhet dhe praktikohet.

Njeriu i formuar dhe i ngritur, çdo gjë që e lexon përputhet me diturinë e tij, kurse njeriu jo i formuar dhe jo i ngritur atë që lexon e përdor në mënyrë sipërfaqësore ose e keqpërdor.

Ai që nuk të do dhe atë që e urren është më së miri që ta harrosh përgjithmonë.

Ai që nuk të do, është mirë ta harrosh.

Preciziteti është aftësi e koncentrimit të shëndoshë.

Vetia kryesore e njeriut është kur dijmë ta kontrollojmë vetveten çka mendojmë, çka flasim, çka dijmë dhe çdo gjë që është e dobishme për vetveten.

Përtacia e njeriut e neutralizon kohën dhe mendimin e shëndoshë. Përtacia e dëmton kohën duke mos ditur se çka është duke ndodhur në të.

Nëse e respekton dhe e don kohën, përtacia vetvetiu zhduket.

Bashkimi i forcave intelektuale janë forca hyjnore e njerëzimit.

Bashkimi dhe bashkëpunimi i forcave intelektuale, në çdo rast është shpëtimi i kombit.

Sëpari njeriu duhet të jetë i formuar shpirtërisht dhe dituria e mësuar do të shërbej vetëm për të mirë.

Dituri dhe edukatë duhet t'iu japim atyre të cilët kanë karakter të shëndoshë.

Ata të cilët nuk kanë interes të lexojnë, nuk mund ta ndryshojnë vetveten.

**Ai i cili nuk e ndryshon vetveten, nuk çmohet nga të tjerët.**

**Ai i cili nuk e njeh vetveten, nuk e ka ndryshuar veten.**

Derisa të mundohesh që t'i mbash nën kontroll të tjerët, atëherë kontrolloje sëpari vetveten.

Ata që të kanë lënduar më së miri është t'i harroni ato sepse nëse të shkon mendja e keqe do të jetë shumë e dëmshme për ty.

Kur mund të dëmtohesh nga bëmirësia e jote? Nëse dikë e do apo dëshiron t'i ndihmosh, ka mundësi që e mira jote të kthehet në të keq. Nëse e keni bërë të mirën pa vend, e keni dëmtuar sëpari vetveten.

Njerëzit me ndjenja të mira shpirtërore janë të rrallë. Më lehtë është ta gjesh një xehe me ari se sa një individ të tillë.

Nëse me kujdes e gjen partnerin shokun apo shoqen me tipare të shëndosha, me besnikëri dhe respekt të shëndoshë, këtu padyshim mund ta filloni bashkëpunimin për të ardhmen e suksesshme.

Studimet dhe shkollimi janë më së shpeshti forma të zanateve ku nuk don të thotë që secili që ka diplomë të varur në mur është i



përsosur dhe me diturinë që e ka mund të bëj përparime në shoqërinë njerëzore.

Intelektualët që kanë studiuar dhe ata që nuk kanë studiuar mund të jenë të barabartë në shoqërinë njerëzore. Është fjala për ata që kanë intelegjencë dhe njohuri të gjerë, goftë të studiuar ose të pastudiuar.

Ata të cilët kanë marrë pozitë të lartë dhe nuk bëjnë asgjë janë poaq të rrezikshëm sa armiku.

Çdo individ që është mendjelehtë dhe beson në gjëra të pavërtetuara mund të quhet besimtar i dobët.

**Unë i besoj asaj që zhvillohet dhe përparohet.**

**Kontaktet kryesore duhet t'i mbani me kategorinë e njejtë të shoqërisë që të jeni më i suksesshëm sepse ata që dëgjojnë dhe kuptojnë janë shumë të aftë.**

I larti i kupton të ultët, të ultit nuk mund ta kuptojnë të lartin.

**I mençuri e ka fitimin e lehtë. Ata të cilët nuk marrin dituri në jetën e përditshme, fitimin e kanë shumë të zorshëm.**

Nëse do dikë ta skllavërosh, jepi detyra dhe mendime të kohës së kaluar.

Njerëzit që e bëjnë jetën të vështirë, shkaktar është kufizimi diturive të tyre.

Njeriu i hapur është i lirë dhe universal.

Njeriu i hapur e kupton të mbyllurin, i mbylluri nuk e kupton të hapurin.

Duke lexuar, njeriu pastrohet shpirtërisht. Sa më i koncentruar aq më pak ka egoizëm dhe aq më shumë ka ngrohje shpirtërore.

Nëse i beson intelegjencës tënde, atëherë zbatoje atë në praktikë.

Mirë është të keshë dije të shëndoshë, por më së miri është të zbatosh diçka nga kjo dije.

Një shprehi e keqe por e vogël, don të thotë fillimi i mbrapshtë i saj.

Çkado që ndodh si fillim, është fillim qoftë nga koka apo bishti.

Njëanshmëria e idesë, e mendimit qoftë shumë e drejtë dhe e qëlluar, nuk do të mjaftoj për strategjitë e ndryshme të jetës.

Dituria e pastër dhe e përsosur është hyjnore, kurse dituria gjysmake është djallëzore.

Ata të cilët i nënshtrohen njëanshmërisë, jo se mbesin vetëm të kufizuar por ata mbesin të çrregulluar.

Sa më larg vetëdijës, aq më afër besimeve të kota, injorancës dhe hutisë.

Besimtarët e rrejtshëm i frigohen të sotmes, të ardhmes, jetës dhe vdekjes.

Mendjelehti kërkon shpëtim në besim të kotë.

Shumë besimtarë të varfër e jetojnë këtë botë, për të besuar në gjërat e trilluara dhe nga historitë e së kaluarës.

Tek besimtarët e rrejshëm përfshihen të gjitha halucinacionet dhe frikat e botërave që nuk i përkasin jetës së tashme.

Me ndihmën e vetëdijës sonë i luftojmë të gjitha traumat, pasiguritë, dyshimet dhe sëmundjet tjera psikike.

**Vetëdija është forcë, siguri, jetë, përjetim, gëzim, trimëri dhe dashuri.**

Ai që beson në mënyrë sipërfaqësore, nuk e njeh vetëdijen. Vetëdijës nuk i duhet besimi sipërfaqësor por i mjafton vetëm vështrimi i thellë para tij.

Besimtarët e rrejshëm janë njerëz të mallkuar.

Të keshë kontroll mbi vetveten, don të thotë të jeshë në vetëdije të plotë.

**Hyjnia kozmike e gjithësisë është Tashmëri, Vetëdije dhe Dashuri.**

Çdo gjë e tashme është hyjnore dhe e rëndësishme. Të kaluarat janë prapambeturi.

Më së miri është për të biseduar, menduar aq sa mundesh ta zbatosh në jetën e përditshme.

**Atë që e flet duhet të jeshë në gjendje edhe ta argumentosh.**

Ai që beson rrejshëm, të mashtron; ai që trillon, të tradhëton.

Besimtari i rrejshëm e mashtron vetveten dhe atë ia imponon tjetrit.

Për besimtarët e rrejshëm ajo çka ndodh sot është më e parëndësishme se e kaluara.

Ai që nuk e përjeton jetën në këtë botë, shpreson kot në parajsën e botës tjetër.

Dituria e besimtarit është të mbajturit mend, kurse dituria e shkenctarit është të studiuarit dhe të vërtetuarit në praktikë.

Parajsa dhe Ferri janë ardhmëria e  
besimtarëve të rrejshëm.

Besimtarët e rrejshëm më shumë i frigohen  
Zotit se sa e duan.

Njeriu i lirë dhe i ngritur shpirtërisht, Zotin  
më shumë e përjeton se sa që e emëron.

Besimtarët e rrejshëm Zotin më shumë e  
emërojnë se sa e përjetojnë.

Njeriu i lirë dhe i ngritur shpirtërisht di ta  
përjetoj Dashurinë dhe Hyjninë.

Njeriu i lirë përjeton çdo gjë me vetëdije,  
kurse njeriu jo i lirë beson në gjëra të  
kaluara në mënyrë të pavetëdijshme.

Nëse e tepron duke e madhëruar dikë qoft  
të gjallë a të vdekur, mund ta rrezikosh  
lirinë tënde.

Ata të cilët kanë intelegjencë të varfëruar,  
krenohen kur t'i madhërojnë njerëzit e tyre.

Respekti dhe madhërimi nuk janë njejtë. Ai  
që e përul veten, e madhëron dikë tjetër.

Ai që e njeh vetveten, di ta respektoj tjetrin.

Ata të cilët mirren vetëm me besim, jetojnë vetëm si parazitë në këtë botë. Ata shumë pak i kontribuojnë njerëzimit, zhvillimit material dhe atij shpirtëror.

Ai që beson rrejshëm, nuk e njeh botën shpirtërore në realitet, por e njeh vetëm në mënyrë iluzore.

Individi apo populli i cili i ka duart e përvjelura, atë çka di e thotë dhe e bën.

Jopërparimtari nuk e thotë atë çka e mendon e as nuk e bën atë çka thotë.

Disa besimtarë nuk e thonë atë çka e dijnë, por atë çka e mendojnë.

Disa besimtarë atë çka e mendojnë nuk e kuptojnë por vetëm e besojnë.

Individi i përparuar brenda 24 orëve mendon vetëm aq sa ka për të vepruar dhe ai momentet e volitshme i shfrytëzon, përjeton dhe i shijon.

Mendimet e shfrenuara e qojnë njeriun deri në çmenduri.

Problemet psikike e detyrojnë njeriun të kaloj në besime të rrejshme dhe mendon se aty e gjen shpëtimin.

Njeriu i lirë me Hyjninë nuk manipulon dhe nuk e përdor vetëm si fjalë por e respekton.

Shumë besimtarë në botë, në emër të Zotit përlyhen me gjak, urrejtje dhe dashuri të rrejshme. Besimtarët e tillë gjykojnë e terrorizojnë për hir të Zotit.

**Çdo gjallesë në këtë botë është Hyjni  
Çdo hapësirë, çdo lëvizje, Mrekulli  
Dhe Gjithësia është Hyjni**

**Ai që di ta shijoj jetën në këtë botë, e  
njuh edhe çështjen shpëtore më mirë.**

Besimtarët e rrejshëm Librat e Shenjtë i kanë keqpërdorur.

Frigo hem që të jemë i friguar.



Që të evitohen harresat e panevojshme, ne duhet të mësohemi që të jemi sa më të qartë në veprimet tona si p.sh. çka bëjmë, si bëjmë, çka duhet bërë. Veprimet e sigurta nuk na lënë të harrojmë.

Gjatë jetës së përditshme, sa kohë kujtoni, sa kohë mendoni, sa studioni dhe sa bëni atë që dini?!

Kujto të kaluarën sa më pak ose aspak, ruaju dhe mos mendo shumë e pa nevojë sepse e humb kohën kot! Studio diçka të re, analizo ato të saktat dhe mbështetju dijes se vetëm dija është sukses dhe të bën të lumtur.

Duaje atë që duhet dashur!

Me problemet që na pengojnë nuk bën të mirremi por duhet kohën kryesore ta angazhojmë në organizimin dhe sistemimin e zgjedhjes së problemit.

Përgjegjësia jonë kryesore është që ta njohim veten sa më mirë.

Individi i cili është në rregull i beson vetvetes dhe e njeh vetveten, ndërsa ai i cili nuk i ka këto virtyte, bie në humnerë.

Në momentet e gjendjes së dobësuar lajmërohen ata të cilët ta duan të keqen.

I rrezikuar je nga e keqja atëherë kur momentet tuaja janë të dobësuar. Mos lejo gjendja të të dobësohet.

Unë mendoj se me vetvete nuk kam probleme, por siç duket probleme kam me rrethin ku jetoj.

Ai që i dëgjon vetëm dëshirat e veta, mund të gaboj, ndërsa ai që i dëgjon dëshirat dhe aftësitë e tij do të ketë sukses.

Ai që di të shes patriotizëm, di edhe të gënjej.

Në bazë të gjendjes së disponimit, paraqiten edhe mendimet e ndryshme.

Ai që vështron, mëson dhe përjeton. Ai që vetëm mendon nuk mëson e as përjeton por vetëm ëndërron.

Koha e sotme është ekuilibri i njeriut dhe i Hyjnisë.

Çdo këndvështrim e ka domethënien e vet, ku domethëniet e ndryshme kuptohen në bazë të këndvështrimeve.

Në të njejtën kohë i bëjmë dy jetë: realja është e zgjuar dhe jorealja është e fjetur. Këto dy jetëra janë paralel njëra me tjetrën.

Bota joreale e fjetur me syçel mund të jetë tepër e rrezikshme nëse i kushtohet shumë kohë. Që ta ruajmë drejtpeshimin, duhet t'i kushtojmë sa më shumë kohë botës reale, së zgjuar ose syçelur.

Botën reale duhet ta kontrollojmë mirë duke ia kushtuar rëndësinë maksimale. Bota reale, e zgjuar, na ndihmon që të mbrohemi nga emocionet e rrejtshme apo të mashtrueshme.

Çdo veprim i bërë që ka buruar nga mendja, mund të jetë shumë i mashtrueshëm.

Veprimet e sigurta janë kur burojnë nga dituria e studiuar.

Ata të cilët bëjnë veprime në punët e tyre nga ana e mendimeve janë shumë të rrezikuar në jetën e përditshme.

Çdo mendim vepron drejtpërsëdrejti në mënyrë të automatizuar, qoftë mirë apo keq.

Është rrezik për ata të cilët dirigjohen nga emocionet e tyre.

Dyshimi është pasojë e mendimeve të gabuara.

Në përputhje me vendimet e mëhershme dhe të fundit mund të paraqitet dyanshmëria.

Nëse një vendim e ke marrë më herët dhe të njëjtin me atë të vonshmin, shpeshherë paraqiten pavendosmëri kundrejt njëra-tjetrës.

Nëse vendimi i parë paraqitet si pavendosmëri dhe të njëjtën kohë paraqitet

edhe një mendim tjetër, atëherë ky i fundit mund të jetë më pak i relizuar.

Vendimi i fundit që fillohet për tu zbatuar, rrënjën e ka në vendimin e parë që është dhënë.

Shpeshherë ideja e parë që lajmërohet për ta marr një vendim, dominon në idetë tjera pas kësaj të parës.

Atë që e shpreh me fjalë, duhet ta dokumentosh me vepër.

Ai që është UNË, është i zgjuar, i vetëdijshëm, e ka lirinë e vet dhe aftësi për të organizuar jetën.

Ai që nuk është UNË, është i fjetur, jo i vetëdijshëm, nuk e ka lirinë e vet dhe nuk di ta organizoj jetën.

Nuk bëhen gjërat vetëm pse ke menduar, por mirë duhet studiuar.

Nëse keni kohë të mendoni, duhet të keni kohë të shikoni, vështroni, përjetoni dhe të studioni.

Nëse vetëm mendoni, atëherë pak shikoni, pak përjetoni dhe pak dini.

Nuk është vështirë ta bësh një punë, vështirë është t'ia fillosh. Fillimi i një pune do një analizë të qëlluar.

Ai që kërkon gjëra që ia zbukurojnë dhe përmirësojnë jetën, nuk do të ketë nevojë të kërkoj shpëtimin e saj.

Dijen që e kemi, është më e vogël se fshehtësitë që nuk i njohim. Duhet besuar pra, më fort diturisë së dijes që gjendet në fshehtësitë e panjohura.

Ata që kanë aftësi të iniciativave të vetorganizimit, i zgjedhin shumë probleme të shoqërisë.

E vërteta nuk është çështje e besimit e as besimi nuk është çështje e vërtetës. E vërteta është çështje e Universit, e besimi është çështje e mendjes së njeriut.

Fetari e njeh të vërtetën ashtu si e ka besimin.

Mendimet e tepruara e dëmtojnë diturinë, e bëjnë shpërlarjen e trurit.

Mendimet rrugaçe mund t'i quajmë ëndërra të tepruara

Sëmundja e mendimeve jo vetëm që krijon iluzione dhe fantazi, por edhe e bën jetën djallëzore.

Nxënësi, profesori, doktori apo shkencëtari më i lartë nëse fillon të mirret me mendime të tepruara, drejtpërsëdrejti fillon t'i humb aftësitë e arritura.

Ai i cili është nën ndikimin e madh të mendimeve, i ka dy rrugë të pasigurta: të bëhet i çmendur apo i humbur.

Mendimet e tepruara janë dituri të ferrit.

Mendimet e njeriut janë dituria më primitive.

## **Vetëdija është dija më moderne e civilizimit.**

Ai i cili e ka mundur mendjen rrugaçe, e ka fituar paqen shpirtërore, e ai që e ka paqën shpirtërore, e ka fituar Vetëdijën Hyjnore.

Njeriu i njuh tri dimensionet kozmike: të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen. Në këtë rast dimensionin kryesor për Hyjninë apo Universin është *koha e tashme*.

Gabimet e bëra e pengojnë edhe diturinë e arritur deri më tani.

Sa më pak të gabuar, aq më të fituar.

Gabimet e bëra e pengojnë suksesin.

Gabimet e bëra janë mungesa e vetëdijës.

Gabimet e pakontrolluara mund të përsëriten dhe pengojnë suksesin.

Mendimet e tepruara nuk e lënë njeriun kurrë të qetë në jetë.



Mendimet janë rruga e papushuar dhe e pandalur e çdo sekondi të kohës së njeriut.

Vetëm vetëdija mund të dominoj mbi mendimin.

**Kujdes! Mendimi të mos dominoj mbi vetëdijën.**

Ai që përjeton, ndryshon.

Kur flet për veten, e tregon të vërtetën.

Ai i cili e tregon vetveten, e zbulon të vërtetën.

Mendimet apo ëndërrat e tepruara janë pjellori e Hyjnive të rrejshme.

Studimi dhe dituria është mbrojtje më e mirë kundër mendimeve të tepruara.

Çdo njeri që është i preokupuar nga sëmundja e mendimeve, është i mjerë.

Stresi dhe arti nuk përshtaten njëri me tjetrin.

Mendimet e pakontrolluara e krijojnë stresin.

Në bukurinë e artit nuk ka mendime të dëmshme, por ka vetëm vrojtime dhe kënaqësi të shumta.

Pasi që i kam përvjelur duart, çdo detyrë e imja do të jetë e kryer me sukses.

Ai i cili nuk di t'i kontrolloj mendimet e veta do t'i nënshtrohet mendimeve të kota.

I vetëdijshmi, i vetorganizuari bën tu ndihmon atyre që kanë nevojë, por mundësisht jo direkt, sepse ai që pret ndihmën e dikuj tjetër, është në gjendje ndërkohë atë ta keqpërdor.

Nëse i ndihmon dikuj në mënyrë indirekte, të dy palët jeni të fituar.

Po deshe t'i bësh mirë dikuj, mos gabo të rrezikosh gjithçka tënden që ke arritur.

Ai i cili nuk e vlerëson ndihmën, nuk di ta kthej atë.

Nëse flet mirë, më shumë ke fituar ti, e  
nëse bën mirë, më së shumti ke humbur ti.

Më shumë fiton kur flet mirë se kur bën  
mirë.

Kritikën me vend duhet bërë me fjalë të  
mira dhe të qeta.

Nëse kritikon me vend, por bëhet me fjalë  
të ashpra, e merr kuptimin e grindjes.

Bashëpuno vetëm me ata të cilët i takojnë  
profilin tënd apo gjenden në rangun tënd.

Nuk jetohet duke iu nënshtruar mendimeve  
të pakontrolluara.

Nëse gjërat hyjnore keqinterpretohen,  
marrin kahje djallëzore.

Vetëm ai që është i vetëdijshëm, e njeh  
fuqinë Kozmike dhe Hyjnore.

Çka është më mirë o njerëz, të dijmë apo të  
besojmë?!

Ne për dritën, a ka nevojë më shumë të besojmë apo të dijmë?!

Sa më shumë që e shfrytëzojmë dritën për trupin tonë, aq më shumë do të kemi energji.

Mbështetuni diturisë që e keni e jo mendimeve rrugaçe.

Më mirë është të bësh vepër të mirë se sa flasësh fjalë të mira.

Sa më shumë që flet, aq më pak bën.

Pse Ilirët, pasardhësit e shqiptarëve, diellin e kanë pasur simbol të shenjtë? Mirëpo, dielli në atë kohë nuk është njohur si yll, por si dritë dhe burim i energjisë.

Sot njerëzimi dritën e njeh si energji kyesore në planet dhe univers. Çdo jetë që zhvillohet, burimi kryesor është drita.

Besoj se drita e ka krijuar universin dhe jetën. Pra, me këtë nënkuptojmë pa humbur kohë, drita është Zot sepse nga kjo jemi krijuar ne dhe gjithësia.

Shpeshherë thuhet në popull, të dalim në ajër të pastër që të freskohemi. Në të vërtetë, mbushesh me energji nga drita e jo vetëm nga oksigjeni. Oksigjen mund të ketë përafërsisht gjithkund njejt sikur molekulat e ujit e ajrit, por drita gjendet dhe shtrihet më së shumti në pozita diagonale.

Biznesmenët, studentët, intelektualët dhe gjithë të tjerët kanë nevojë sa më shumë ta shfrytëzojnë dritën nëpër terasa dhe oborre të shtëpisë. Në këtë mënyrë truri do të jetë më i freskët e ndjenjat në përgjithësi zgjohen më shumë. Kjo është shenjë e energjisë aktive dhe rregullim të sistemit imun. Ai që e shfrytëzon dritën e diellit, më mirë e ruan peshën e trupit dhe bukurinë e ka mashkulli më mashkullore dhe femra më femërore.

Po e përsëris, sidomos për biznesmenët dhe intelektualët: largojuni lokaleve të errëta si natën, ashtu edhe ditën. Kërkojini vendet me sa më shumë dritë dhe do ta shihni sa shumë gjëra, sidomos vetëdija do të zhvillohet më fort. Intelegjenca dhe

[www.sa-kra.ch](http://www.sa-kra.ch)

[www.syri3.com](http://www.syri3.com)

imuniteti përmes vetëdijës është shumë më  
i fortë.

*Çdo hap që përcillet me tingullin e vetëdijës,  
paraqet zgjimin dhe mirëfillin tënd.*

*Hyjnia kozmike është Tashmëri,  
Vetëdije dhe Dashuri.*

*Në kohën e tashme tenton gjithnjë e ardhmja.  
Ne duhet të mundohemi gjithmonë ta vrojtojmë  
dhe përjetojmë të tashmen me ndjenja,  
emocione, dashuri, frymëzim e harmoni  
sepse e tashmja është gjithçka dhe mund  
të thuhet materialiste. E ardhmja dhe  
e kaluara janë idealiste apo si lloj ëndrre.*